

## KISHA E SHËN SOTIRËS - VUNO / HIMARË<sup>1</sup> PIKTURA MURALE



Kisha ka qenë dekoruar me pikturë murale, prej së cilës kanë mbetur vetëm pak skena në ambientin e bemës, në absidë dhe niken e protezisit. Në absidë paraqitet figura e Shën Mërisë Platitera ndërsa në protezis kemi paraqitjen e Krishtit Njeri i Dhimbjeve ose Poshtërimi i Skajshëm. Piktura murale e kishës së Sotirës paraqet një fazë të realizimit. Piktura është punuar me teknikën e afreskut, ndërsa vizatimi i skenave, paraprakisht mendohet se është realizuar me shabllone. Teknika e realizimit të shtresave parapërgatitore vërehet qartë dhe konsiston në arricion, intonaco dhe peliculin, të cilat mbështeten mbi aparatin e murit të ndërtuar me gurë të latuar të lidhur me llaç gëlqereje.

### Problematika e pikturës:

- Shkëputje e shtresës së arriccios nga muri, (xhepa)
- Çarje dhe plasaritje të suvasë së pikturuar
- Dëmtim i intonacos dhe peliculit
- Mbulimi i shtresës së pikturës nga shtresa e kripës dhe e pluhurit
- Depozitime të blozës
- Lyerje me gëlqere



### Ndërhyrjet konservuese - restauruese:

- Konsolidimi i arriccios me murin
- Konsolidimi i intonacos me arricion
- Mbushja e xhepave (hapësira midis murit dhe arriccios)
- Plumbime (mbushja e lakunave ose boshillëqeve)
- Qepja e çarjeve
- Konsolidimi i peliculit
- Heqja e shtresës së blozës dhe mbetjeve vajore të qirinjeve
- Pastrimi i sipërafares së afreskut nga pluhurat
- Heqja e kripërave të kalciumit
- Pastrimi nga depozitimet organike të paqëndrueshme
- Pastrimi i sipërafares së pikturës nga gëlqerja

